



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 20.11.2018, ora 09:00

Drejton mbledhjen:

Milva Ekonomi – nënkryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Diskutim për mosparaqitjen e z. Zylyftar Bregu, anëtar AMA-s, në seancën dëgjimore të thirrur prej Komisionit, në kuadër të shqyrtimit të kërkesës së Kryetarit të AMA-s, për fillimin e procedurave për lirimin nga detyra si anëtar i AMA-s.

Marrin pjesë:

Milva Ekonomi, Fidel Ylli, Ismet Beqiraj, Vilma Bello, Adelina Rista, Fadil Nasufi, Bujar Çela, Almira Xhembulla, Musa Ulqini dhe Anduel Xhindi (zëvendësues).

Mungojnë:

Fatmir Velaj, Albana Vokshi, Luçiano Boçi, Luan Baçi, Romeo Gurakuqi, Valentina Duka, Shezai Rrokaj, Nora Malaj dhe Kejdi Mehmetaj.

HAPET MBLEDHJA

Milva Ekonomi- Mirëmëngjesi të gjithëve!

Sot jemi mbledhur për një dëgjese me zotin Bregu lidhur me një çështje, konflikt interesi, paraqitur në komisionin tonë parlamentar, sipas një procedure të ndjekur nga shërbimet e Kuvendit.

Fidel Ylli – Korumi është i plotë dhe ne mund të vazhdojmë mbledhjen.

Milva Ekonomi – Të nderuar kolegë, siç e dini në datën 11 nëntor ne kemi marrë një shkresë nga sekretari i Përgjithshëm i Kuvendi, ku tregohet një procedurë që duhet ndjekur, referuar të gjitha ligjeve që rregullojnë veprimtarinë tonë, siç është ligji i parandalimit të konfliktit të interesit dhe Rregullorja e Kuvendit, apo edhe ligjit që ka të bëjë me funksionimin e mediave audiovizive në Shqipëri, për një konflikt interesi të një anëtari të bordit drejtues të AMA-s, zotit Zylyftar Bregu.

Ne e thirrëm në dëgjese në datën 13 nëntor. Zoti Bregu kërkoi kohë të njihej me dokumentacionin që ne dispononim. Po atë ditë, i vumë në dispozicion të gjithë këtë informacion. Ia dërguam atë si në formë elektronike, ashtu edhe shkresore, në adresën e tij personale të banimit dhe e lajmëruam për një dëgjese sot, në orën 9:00.

Zoti Bregu ka lajmëruar pak minuta para se të fillonte dëgjesa që, për arsye shëndetësore, e ka të pamundur të vijë.

Ne kemi vepruar në këtë rast sipas pikës 3, të nenit 115, të Rregullores së Kuvendit, për shkarkimin e anëtarëve të organeve të krijuara me ligj, sipas procedurës së dëgjimit, pyetje-përgjigjeve, marrjes së vendimit nga komisioni, të shkarkimit, të lirit, e të gjitha mundësive që të jep ky nen i Rregullores.

Ndërkohë, zoti Bregu nuk ka ardhur sot për arsye shëndetësore. Unë do të pyes nëse këto arsye shëndetësore që ai ka paraqitur janë të justifikueshme, sipas dokumentacionit përkatës që pranon shtyrjen e një dëgjese të tillë.

Do të kërkoja, gjithashtu, të kishim mundësi për një kërkesë të dytë dëgjese, pra t'i japim edhe një shans tjetër zotit Bregu, që të vijë edhe një herë para komisionit.

Përveç kësaj ne kemi marrë sot në *e-mail* një kërkesë nga grupi i LSI-së, i cili ka komunikuar me sekretarinë dhe na e ka nisur të gjithëve. Unë po ju lexoj tekstin, ku thuhet se “Grupi i LSI-së në komision ka bërë një kërkesë, e cila është trajtuar në mbledhjen e fundit të komisionit (në fakt, jo në mbledhjen e fundit, në disa mbledhje më përpara, kur ne kishim thirrur zotin Bregu) Ne kemi kërkuar që para se të zhvillojmë procedurën, të njihemi me materialin e plotë, që duhet t’u kërkohej shërbimeve të Kuvendit dhe ILDKPKI-së. Është në traditën e mirë të këtij komisioni që para marrjes së vendimeve, sado politike dhe të njëanshme të jenë ato, të dëgjohet dhe të kërkohej çdo material, që do ta bënte procesin transparent në sy të publikut. Nxitimi juaj dhe mosmarrja parasysh e kërkesës sonë, shton më tej dyshimin që procedura që filluat dhe

po ndiqni, fillimisht nga kryetari i AMA-s dhe, më pas, nga shumica në këtë komision, ka një prapavijë të pastër politike dhe bëhet me qëllimin e marrjes së kontrollit të shumicës në AMA. Ne u kërkojmë edhe një herë anëtarëve të komisionit dhe drejtuesve të saj, para se të vazhdojnë procedurën, të bëjnë sa më poshtë:

-Të kërkojnë informacion nga shërbimet e Kuvendit pse kandidatura e zotit Bregu nuk është skualifikuar nga procesi në vitin 2016, pasi marrëveshja që i referohet kërkesa është lidhur që në vitin 2015 dhe është deklaruar në deklarin vjetor pasuror të zotit Bregu

-Të kërkojnë informacion me shkrim nga ILDKPKI-ja, si institucion i ngarkuar nga ligjvënësi për verifikimin e konfliktit të interesit, të verifikojë saktësinë e referencave ligjore të përmendura në shkresën shoqëruese të ardhur nga sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit.

Së fundi, nuk u takon anëtarëve të komisionit tonë të marrin mbi vete role që nuk u takojnë atyre ose që nuk janë të aftë t'i kryejnë. Pa fakte dhe të dhëna zyrtare, nuk mund të bëjmë rolin e gjyqtarit.

Ju ftoj edhe një herë t'i ktheheni rrjedhës ligjore dhe institucionale në vazhdim të kësaj procedure!

Faleminderit!”

Unë mendoj se duhet të kthejmë përgjigje, sepse ka ardhur me shkresë zyrtare.

Pavarësisht kërkesës që ka bërë grupi i LSI-së në komision, unë besoj se deri tani ne kemi ndjekur hap pas hapi të gjitha procedurat.

Mundësia që i japim zotit Bregu për ardhje tjetër para komisionit, besoj se është sipas procedurave që ne kemi.

Caktojmë një grup prej 2-3 vetash për t'i kthyer përgjigje grupit të LSI-së dhe dakordësojmë tekstin e draftuar.

Kush mendon se duhet të jetë në këtë grup?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ne duhet të kthejmë përgjigje të përbashkët.

A keni ndonjë gjë për të shtuar?

A do të ketë një mbledhje me qëllimin e mirë të thërrasim edhe një herë në dëgjuesë zotin Bregu?

Musa Ulqini- Ne nuk kemi të drejtë të paragjykojmë që ai ka përdorur faktin se është i sëmurë, si një mundësi për ta shtyrë, kështu që ne e respektojmë kërkesën e tij për këtë fakt dhe i

lëmë kohë. E mbyllim diskutimin në një mbledhje që të jetë e përshtatshme, sepse nuk ka kuptim të shtyjmë mbledhje, përveç mbledhjes që do të jetë.

Milva Ekonomi – Kemi për t’i caktuar një datë, por ajo lidhet edhe me aktivitetet e javës në vijim.

Duhet të biem dakord për kohën që do t’i lëmë zotit Bregu për të ardhur dhe i kërkojmë sekretarisë së komisionit, që të lajmërojë zotin Bregu. Ndërkohë do t’i kërkohet justifikimi i mungesës së sotme.

Ismet Beqiraj- Edhe unë këtë doja të thosha: t’i kërkohet justifikimi i mungesës së ditës së sotme. Nëse ai ndjek traditën jo normale të shtyrjes së këtij ballafaqimi, atëherë komisioni do të lërë një afat sipas Rregullores së veprimtarisë së Kuvendit, sepse mund të ndodhë që të marrë leje të gjatë deri në dy vjet.

Milva Ekonomi- Faleminderit!

Do të njoftohemi edhe për draftletren, edhe për kohën që i jepet zotit Bregu.

Nesër kemi dy aktivitete: një trajnim e ILDKPKI-së dhe një aktivitet që bën OSBE-ja për medien.

Ai që dëshiron të marrë pjesë tek aktiviteti i dytë, është i mirëpritur nga OSBE-ja.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA